



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 88

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10

Prishtinë, më 29 janar 2014, në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Salihe Mustafa, Nazane Breca, Flora Brovina dhe Bahri Thaçi.

Mungoi : Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 24.1.2014;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 24.1.2014;

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24.1.2014.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;

Fikrim Damka- tha se pasi Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka sjell raportin lidhur me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropiane, ne mund të votojmë sot për amendamentet dhe ta përcjellim raportin për miratim në Kuvend. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar një amendament dhe duhet të deklarohemi fillimisht për amendamentin e propozuar nga Komisioni për Buxhet e pastaj t'i miratojmë amendamentet tona.

Propozimi i Komisionit për Buxhet dhe financa është si vijon :

Në nenin 8, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri si vijon :

6. E drejta në pension ju njihet punëtorëve të arsimit dhe punëtorëve tjerë të larguar me dhunë nga puna. E drejta dhe përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për pension kontributpagues të moshës, për punëtorët e Kosovës të larguar me dhunë nga puna, apo të shpallur si tepriçë teknologjike pa bazë ligjore, në vitet 1989 deri 1999, do të rregullohet me akt të veçantë ligjor.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që amendamenti 7, i Komisionit Funkcional, të hiqet.

Bahri Thaçi- tha se ndoshta amendamenti i Buxhetit është më i fuqishëm se i Komisionit tonë, megjithatë unë jam për amendamentin e propozuar nga Komisioni për Integritet Evropiane .

Nazane Breca- theksoi se do ta përkrah amendamentin 7 , të propozuar nga Komisioni për Integritet Evropiane.

Time Kadrijaj –Unë mendoj se te amendamenti 7, do ta përkrah propozimin e Komisionit për Buxhet , ndërsa sa i përket amendamenteve tjera, sidomos atyre të pensioneve të parakohshme të punëtorëve të Trepçës, mendoj se Komisioni për Buxhet nuk ka pasur të drejtë që nuk i ka përkrah.

Flora Brovina - theksoi se edhe ajo i përkrah pensionet e parakohshme të punëtorëve të Trepçës.

Salihe Mustafa tha se edhe ajo pajtohet që të kalojë amendamenti 7, i Komisionit të Buxhetit, ndërsa, sa i përket pensioneve të parakohshme të punëtorëve të minierave, theksoi se do të abstenoj, sepse as ministria e Punës e as përfaqësuesit e punëtorëve nuk kanë arritur të na sqarojnë se a do të rritet numri i përfituesve. Unë jam dakord ti marrin prapë pensionet ata që janë duke i marrë , por jo të shtohet numri.

Sasha Gjokiq - tha se edhe unë do ta përkrah këtë amendament sepse të gjithë ata të cilët janë larguar nga puna pa të drejt duhet t'i marrin pensionet. Por, mendoj se duhet të jetë e hapur mundësia që qytetarët të kenë të drejt të marrin edhe pension tjetër, ku kanë kontribuar.

Pas diskutimeve , me 5 vota për dhe 2 kundër , Komisioni miratoi amendamentin e propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa .

Pastaj Komisioni votoi amendamentet tjera, dhe me shumicë votash u miratua raporti me amendamente dhe u procedua për miratim në Kuvend.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka